

STATUT
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

MANIAL SHPK

Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktion e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Në mbështetje të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, themelohet shoqëria **Manial SHPK**, veprimtaria e së cilës do të organizohet dhe drejtohet sipas dispozitave të këtij Statuti.

Neni 1
Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me Statutin dhe legjislacionin shqiptar.

Neni 2
Ortakët e shoqërisë

Ortak i Vetëm i shoqërisë është znj. Brikena Driza, shtetase shqiptare, lindur me 17.6.1991 ne Lushnje e banuese ne Tirane, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 031931131 dhe nr. personal J15617118Q.

Neni 3
Forma ligjore dhe emri i shoqërisë

Shoqëria ka formën e “shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar” ose “**SHPK**”. Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjeter në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Emri i shoqërisë është **Manial SHPK**.



Neni 4
Kohëzgjatja e veprimtarisë

Data e themelimit te shoqërisë është data 27 korrik 2021. Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është i pacaktuar. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 5

Selia

- 5.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Rruga Anemona, Nd.19, H.1, Ap 3, Kashar, Yzberisht, Kodi Postar 1050, Tiranë, Shqipëri.
- 5.2 Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

Neni 6
Dokumentet e shoqërisë

- 6.1. Të gjitha shkresat, formularët e urdhreve apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përbajnë, përvèç emrit të shoqërisë edhe të dhënat e mëposhtme:
 - a) *numrin unik të identifikimit;*
 - b) *formën ligjore të shoqërisë;*
 - c) *vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;*
 - d) *të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;*
 - e) *vlera e kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe vlera e pjesës së paguar të kapitalit;*
- 6.2. Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen edhe aty.

Neni 7



Objekti i veprimtarisë

7.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

- *Veprimtaria e ndërmjetësimit, prodhimit, tregtimit të energjisë së rinnovueshme;*
- *Zhvillimi, ndërtimi, operimi, mirëmbajtja e impianteve të prodhimit të energjisë së rinnovueshme, linjave të transmetimit të kësaj energjie, dhe stacioneve apo nënstacioneve të energjisë elektrike;*
- *Ushtrimi i veprimtarive të ndryshme industriale dhe tregtare, tregimi i artikujve të ndryshëm elektro-shtepiakë, i materialeve të ndërtimit dhe artikujve ndihmës apo të;*
- *Përfaqësimi, ndërmjetësimi dhe bashkëpunimi për veprimtari të ndryshme tregtare të lidhur ose jo me objektin e kësaj shoqërie;*
- *Ofrimi i shërbimeve të ndryshme, asistencës teknike, organizimi i panaireve tregtare dhe kulturore;*
- *Veprimtaria e agjentit postar, të sigurimeve, të udhëtimeve, të marketingut, të reklamave, shërbimeve komisionere, etj.;*
- *Zhvillimi i investimeve në të gjitha fushat, duke përfshirë, por pa u kufizuar në ndërtim, telekomunikacion, tregti dhe shërbime të tjera;*
- *Krijimi i ambienteve shlodhëse dhe parqeve të rekreacionit;*
- *Botimi dhe shtypshkrimi;*
- *Ofrimi i shërbimeve të bar – kafeve, restoranteve, hoteleve, diskotekave, sallave të lojërave dhe argëtimit, qendrave sportive, etj.;*
- *Ne sferën e asistencës teknike, bashkëpunimi me ekspertë vendas dhe të huaj për kryerjen e studimeve tërësore apo pjesore profesionale, financiare, të fizibiliteteve, të tregut dhe të marketingut për zhvillimin e vetë shoqërisë apo në shërbim të të tretëve.*
- *Prodhimi, zhvillimi, dhe tregimi i veshjeve, aksesorëve, me shumicë dhe pakicë;*



- *Krijimi i markave dhe produkteve në shërbim të palëve të treta;*
 - *Zhvillimi dhe menaxhimi ekskluziv te dyqaneve dhe rrjeteve për shitjen e produkteve të lartpërmendura, të markave;*
 - *Ne përputhje me dispozitat ligjore shoqëria ka si objekt të rekrutojë dhe/ose nënkontraktojë agjenci dhe përfaqësues të produkteve dhe/ose shërbimeve që u përkasin grupeve të produkteve të sipërpermendura.*
 - *Kryerja e studimeve të tregut dhe projekteve, sondazheve dhe hulumtimeve të tregut si dhe kryerja e aktiviteteve kërkimore dhe eksperimentuese me përdorimin dhe shfrytëzimin e rezultateve.*
 - *Në funksion të realizimit të objektit të saj, shoqëria mund të blejë dhe/ose investojë në kuota apo aksione kapitalesh shoqëri të tjera, të sigurojë financimin e shoqërive bija brenda rregullave të tregut;*
 - *Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjeter që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.*
- 7.2 Objekti i veprimitarës së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

Neni 8 Kapitali themeltar

- 8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **100 (njëqind) lekë**.
- 8.2 Kapitali përbëhet nga **1 (një) kuotë** me vlerë nominale **100 (njëqind) lekë** dhe zotërohet nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

Neni 9 Transferimi i pjesëve të kapitalit

- 9.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, në rastet kur shoqëria ka më tepër se një ortak. Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm në rast trashëgimie, në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve apo paraardhësve e pasardhësve.
- 9.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek të tretët, qofshin këta subjekte shqiptarë apo të huaj, persona fizikë apo juridikë.

Neni 10

Zmadhimi/zvogëlimi i kapitalit

- 10.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asambleës së ortakëve si dhe në përputhje me kërkesat ligjore.
- 10.2 Ortakët, me kërkesë të thjeshtë të administratorit, në mënyrë unanime dhe në përpjesëtim të drejtë të kuotave që posedojnë, mund të përbushin nevojat financiare të shoqërisë nëpërmjet rrithes së kapitalit ose financimeve (qofshin këto me fitim/interes ose jo), duke respektuar normat e transparencës bankare dhe kërkesat të tjera me karakter fiskal. Rimbursimi i derdhjeve dhe i financimeve te ortakëve mund të bëhet me vendim të ortakëve, siç, me të njëjtat modalitete mund të destinohen për mbulimin e humbjeve eventuale ushtrimore.

Neni 11

Asambleja e Ortakëve

- 11.1 Asambleja e Ortakëve përbëhet nga ortakët e shoqërisë. Ajo drejtohet nga administratori/ët i/e shoqërisë ose nga çdo person tjetër i zgjedhur nga ortakët.
- 11.2 Asambleja e ortakëve ka këto kompetenca kryesore:
 - *ndryshimi i dispozitave të statutit,*
 - *zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit,*
 - *emërimi dhe ndryshimi i administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël,*
 - *miratimi i shpërblimeve të administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël,*
 - *miratimi i llogarive vjetore(bilancit),*
 - *ndryshimi i formës ligjore të shoqërisë,*



- *mbyllja dhe shpërndarja e parakohshme shoqërisë si dhe të tjera të përcaktuara në legjislacionin shqiptar tregtar në fuqi.*

- 11.3 Asambleja e ortakëve mblidhet të paktën një herë në vit dhe sa herë që duhet të vendosë për çështje të kompetencës së saj. Mbledhja mund të realizohet edhe nëpërmjet video-konferencës.
- 11.4 Mbledhja e Asamblesë thirret nga Administratori/ët ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar. Asambleja thirret me anë të një njoftimi me shkrim që u dërgohet ortakëve të paktën shtatë ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi mund të dërgohet edhe nëpërmjet postës elektronike por në çdo rast duhet të përbajë ditën, orën, vandin si dhe rendin e ditës me çështjet që do të trajtohen.
- 11.5 Ortakët mund të përfaqësohen në mbledhje nga persona të tjerë, bazuar në një prokurë të lëshuar paraprakisht, prej tyre.

Neni 12 **Vendimmarrja**

- 12.1 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kapitalit të shoqërisë.
- 12.2 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të shoqërisë.
- 12.3 Asambleja e shoqërisë, vendos me 75% të kapitalit pjesëmarrës (të përfaqësuar nga ortakët), siç parashikohet në pikën 12.2 më sipër, për ndryshimin e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve ose ri investimin e tyre, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Në rastet e tjera, asambleja e shoqërisë, vendos me më shumë se 50% të votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.
- 12.4 Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në një procesverbal, ku shënohet data, vendi, rendi i ditës, emri i drejtuesit të mbledhjes dhe mbajtësit të procesverbalit, çështjet kryesore dhe vendimet e marra. Procesverbalit nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari (mbajtësi i procesverbalit).

Neni 13
Administrimi i Shoqërisë

- 13.1 Shoqëria do të ketë një administrator, i cili emërohet për një mandat 3 (tre) vjeçar. Administratori zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- 13.2 Administratori i parë i shoqërisë është Znj. Brikena Driza, shtetase shqiptare, lindur me 17.6.1991 ne Lushnje e banuese ne Tirane, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 031931131 dhe nr. personal J15617118Q.
- 13.3 Administratori, ndër të tjera, ka të drejtë: të drejtojë veprimtarinë e përditshme të shoqërisë, të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, të paraqesë para Asamblesë së Ortakëve propozime dhe raporte lidhur me aktivitetin e shoqërisë, të çelë llogari bankare në emër të shoqërisë, si dhe të ushtrojë të drejta të tjera të cilat mund t'i njihen nga ligji dhe Asambleja e Ortakëve.
- 13.4 Administratori, bazuar në një vendim të Asamblesë së Ortakëve, mund të emërojë drejtorë, përfaqësues me prokurë dhe të mandatuar të përgjithshëm për veprime të caktuara ose kategori veprimesh.
- 13.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të shesë dhe/ose të blejë pasuri të paluajtshme në emër dhe për llogari të shoqërisë, pa marrë më parë miratimin paraprak me shkrim të asamblesë së ortakëve.

Neni 14
Kontrolli financiar

Asambleja e Ortakëve mund të emërojë një apo disa ekspertë kontabël të cilët kanë detyrën të kryejnë kontrollin kontabël dhe financiar të shoqërisë.

Neni 15
Viti financiar

- 15.1 Viti financiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.



- 15.2 Si përjashtim, viti i parë finanziar i veprimitarisë së Shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 16
Bilanci dhe Dividendët

- 16.1 Në fund të vitit ushtrimor, administratori, merr masa për përgatitjen e bilancit. Bilanci u paraqitet ortakëve për miratim, brenda afateve ligjore.
- 16.2 Asambleja e ortakëve që miraton bilancin vjetor, vendos mbi shpërndarjen e fitimit ortakëve ose krijimin e rezervave si dhe krijimin e rezervave ligjore.

Neni 17
Likuidimi dhe prishja

Likuidimi dhe prishja e Shoqërisë vendoset dhe kryhet në përputhje me kërkesat ligjore.

Neni 18
Dispozita mbyllëse

Ky Statut hartohet në katër ekzemplarë në gjuhën shqipe.

Tiranë, më 27.7.2021.

ORTAKU I VETËM

BRIKENA DRIZA
Brikana Driza


SPECIMENI I NENSHKRIMIT

Une, e nenshkruara:

Brikena Driza, shtetase shqiptare, lindur me 17.6.1991 ne Lushnje e banuese ne Tirane, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 031931131 dhe nr. personal J15617118Q,

do te nenshkruaj si perfaqesues ligjor (Administrator) i vetem i shoqerise ne krijim e siper "MANIAL" shpk, si vijon:

Brikena Driza 
Brikena Driza (specimeni i nenshkrimit)

Tirane, 27.07.2021
(vendi) (data)